

VENDIM
Nr.171, datë 28.3.2007

**PËR PËRCAKTIMIN E STRUKTURËS, STATUSIT, KRITEREVE TË
PËRZGJEDHJES, UNIFORMAVE, ARMATIMIT DHE TRAJTIMIT FINANCIAR TË
FORCËS SË SIGURISË NË ANIJE DHE PORT, PËR PORTET E VLORËS,
SHËNGJINIT DHE TË SARANDËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 33 të ligjit nr.9281, datë 23.9.2004 “Për sigurinë në anije dhe porte”, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Forca e Sigurisë në Anije dhe Port, për portet e Vlorës, Shëngjinit dhe të Sarandës (FSAP), organizohet në varësi të drejtorit të shoqërisë anonime, Porti Detar, sipas strukturës në aneksin 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Shoqëria anonime, Porti Detar, në varësi të rritjes së volumit të punës në port, ka të drejtë të rrisë ose të zvogëlojë numrin e punonjësve të FSAP-së.

2. FSAP-ja zhvillon veprimtarinë në përputhje me Kodin Ndërkombëtar të Sigurisë së Anijeve dhe Porteve, të Organizatës Ndërkombëtare Detare (IMO), me konventën SOLAS, 74, dhe amendamentet e saj, (Kodi ISPS), me ligjin nr.9281, datë 23.9.2004 “Për sigurinë në anije dhe porte” dhe me aktet nënligjore në fushën e sigurisë, të miratuara nga Autoriteti Shtetëror i Sigurisë.

FSAP-ja ka për detyrë:

a) mbrojtjen dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës, të objekteve dhe vlerave të portit;
b) krijimin e një mjedisi, të sigurisë dhe të përshtatshëm, për një punë të pandërprerë, 24-orëshe, me tre (3 turne) për Portin Detar dhe operatorët e ndryshëm, që veprojnë në këtë port.

3. Drejtori i Forcës së Sigurisë në Anije dhe Port i jep llogari, drejtpërdrejt, drejtorit të shoqërisë anonime, Porti, Detar, për të gjithë veprimtarinë e sigurisë në port dhe anijet, që janë të ankoruara, në lëvizje nga dhe në drejtim të portit, ato të radës së portit, si dhe vepron sipas udhëzimeve të tij.

4. Kriteret profesionale dhe komisioni përkatës për përzgjedhjen (rekrutimin) e anëtarëve të FSAP-së hartohen nga shoqëria anonime, Porti Detar dhe miratohen nga Ministri i Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit.

5. FSAP-ja është një forcë e armatosur dhe e pajisur me mjetet e nevojshme, për të siguruar portin dhe anijt nga çdo sulm i mundshëm, terrorist apo keqbërës, si dhe nga hyrja, në mënyrë të kundërligjshme, e shtetasve dhe e mjeteve në zonën objekt kontrolli të FSAP-së. Pajisjet, mjetet, uniforma dhe armatimi përshkruhen në aneksin 1/1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

6. FSAP-ja, për çdo rast konstatimi të veprave penale, gjatë kryerjes së veprimtarisë së vet, siguron vendin e ngjarjes, provat materiale, bllokon autorët dhe njofton strukturat përkatëse të Policisë së Shtetit dhe prokurorinë, duke bashkëvepruar me këto organe për vazhdimin e procedimit penal.

Gjithashtu, FSAP-ja, për çdo shkelje të natyrës doganore, i raporton, menjëherë, degës rajonale të doganave.

7. Komiteti i Sigurisë së Anijeve dhe Portit është organ kolegjal, i cili kryesohet nga drejtori i shoqërisë anonime, Porti Detar, dhe në përbërje ka këta anëtarë:

- Një përfaqësues të Ministrisë së Brendshme.
- Një përfaqësues të Ministrisë së Mbrojtjes.
- Një përfaqësues të Ministrisë së Financave.

- Një përfaqësues të Autoritetit Shtetëror të Sigurisë.
- Një përfaqësues të Drejtorisë së Politikave të Transportit Detar.
- Një përfaqësues të këshillit mbikëqyrës të shoqërisë anonime, Porti Detar.
- Kapiteni i porteve.

8. Komiteti i Sigurisë së Anijeve dhe Portit vlerëson projektplanet e sigurisë dhe bashkërendon punën me palët operuese në port për zbatimin e tyre. Ky komitet mbledhet një herë në tre muaj. Me kërkesë të Autoritetit Shtetëror të Sigurisë ose të shoqërisë anonime, Porti Detar mund të mbledhet në periudha më të shkurtra ose jashtë radhe.

9. Rregullat e brendshme të hollësishme për funksionimin e FSAP-së, në përputhje me këtë vendim dhe në mbështetje të ligjit nr.9281, datë 23.9.2004 “Për sigurinë në anije dhe porte”, miratohen nga këshilli mbikëqyrës i shoqërisë anonime, Porti Detar.

10. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga të ardhurat e shoqërisë anonime, Porti Detar.


11. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit dhe Ministria e Brendshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

ANEKSI 1

SHA
Forca e sigurisë e
Portit Detar



PËRSHKRIMI

I. ARMË

Pistoleta

Shkop zgjatues dhe mbajtës

II. TRANSPORT

Automjet

Mjet lundrues patrullues

III. NDËRLIDHJE

Radio stacionare VHF

Radio dore VHF

IV. UNIFORMA

Verore/dimërore